



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
I MBAJTUR MË 13. 4. 2017**

**PRILL
2017**

KRYETARJA, Përshëndetje për anëtarët e komisionit për Legjislacion po ashtu edhe për të pranishmit. Së pari shpreh keqardhjen time edhe në emër të Komisionit për Legjislacion që Ministria e Drejtësisë sërish nuk është në këtë dëgjim publik ndonëse po bëhet fjalë për një projektligj jashtëzakonisht të rëndësishëm. Po ashtu ne kemi ftuar edhe Këshillin Prokurorial të Kosovës edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe as përfaqësuesit e këtyre dy këshillave nuk janë të pranishëm në këtë dëgjim publik dhe jo rastësisht ka shkuar ftesa tek këto dy këshilla për faktin se kemi shumë raste kur vetë gjyqtarët ndoshta i detyrojnë (si ta themi kështu) gratë të heqin dorë nga trashëgimia. Kemi parë dhe kemi dëgjuar raste të tilla që janë shumta andaj kontributi dhe pjesëmarrja e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial do duhej të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme por siç duket po vazhdon kjo papërgjegjësia karshi Kuvendit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Megjithatë ne po vazhdojmë dëgjimin publik dhe në fillim po e përmend faktin që ky projektligj i ka vetëm dhjetë nene dhe në këto dhjetë nene nuk janë përfshirë ose nuk janë adresuar me çështjet në vazhdimësi që ne jemi përballur si shoqëri, si vajza si gra dhe kjo është arsyeja ndoshta edhe pse kam ftuar shumë organizata që merren me të drejtat e grave dhe vajzave mirëpo siç po shihet edhe në këtë dëgjim publik shumë pak prej tyre e kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe janë të pranishme. Megjithatë ne mund të vazhdojmë dëgjimin publik vetë si fillim po ju informoj se komisioni për Legjislacion e ka votuar në parim këtë projektligj. Po ashtu edhe në seancën plenare është votuar i njëjti, komisioni për legjislacion ka formuar grupin punues i cili do të shqyrtojë këtë projektligj ku drejtues i këtij grupi punues është z. Pal Lekaj nga radhët e Aleancës që është edhe shef i Grupit Parlamentar. E drejta e pronë për të dyja gjinitë mbetet një sfidë aktuale. Ne përballemi me probleme të shumta për shkak të mentalitetit patriarkal. Sot siç duket është bërë një farë rregulli i pashkruar që kur vajzat apo gratë dëshirojnë që të marrin pjesën që i takon me ligj dhe Kushtetutë nga pasuria ato më nuk kanë se çfarë të kërkojnë në familjen e babait për faktin se përjashtohen veç për shkak se kanë marrë pasurinë ose trashëgiminë që i takon me ligj. Ky projektligj nuk adreson këto probleme, ne rastin e fundit e kemi rastin e znj. Shyhrete Berisha e cila edhe sot e kësaj dite po ballafaqohet për shkak se familjarët e bashkëshortit të ndjerë të saj nuk po pranojnë që të jetë ajo trashëgimtare e shtëpisë ku ka jetuar me bashkëshortin dhe fëmijët. Ne duhet ti shikojmë të gjitha mundësitë që këto çështje dmth. ti adresojmë në këtë projektligj dhe mos lejojmë që vajzat dhe gratë të diskriminohen se është një e drejtë kushtetuese që mos t'ua mohojë askush. Unë po ia kaloj fjalën z. Pal Lekaj që është edhe kryesues i grupit punues dhe pastaj te anëtarët e komisioneve dhe pastaj te të pranishmit që janë në këtë dëgjim publik.

PAL LEKAJ, Faleminderit kryetare ! Zonja dhe zotëri faleminderit që ju keni përgjigjur ftesës dhe sot të debatojmë për një gjë me rëndësi për shtetin e Kosovës por edhe për ata që i atakon drejtpërsëdrejti. Si kryesues i grupit punues për projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e ligjit për trashëgimi e Kosovës më lejoni që shkurtimisht të paraqes ndryshimet që janë paraparë në këtë projektligj. Me projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për trashëgiminë e Kosovës që ka vetëm dhjetë nene është paraparë autorizimi i noterëve me kryerjen e disa funksioneve në trashëgimi. Ulja e afatit për njohjen trashëgimisë në mes bashkëshortëve jashtëmartesor është fshirë dispozita për parashkrimin e të drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore se dhe është përcaktuar përfshirja e organit të kujdestarisë në dhënien e lejes sa i përket heqjes dorë në emër të të miturve. Këto janë ndryshimet që janë propozuar në këtë projektligj por duhet të sqaroj se pse deri tash si grup punues nuk kemi filluar punën është sepse si komision për legjislacion kemi pasur një pajtim që projektligji për noterinë të jetë një hap përpara në mënyrë që të ruhet logjika me rastin e amendamentimit të këtyre ligjeve pasi kemi një mori projektligjesh në procedurë dhe është e nevojshme të ruhet konsistenca. Sot, në këtë dëgjim është me interes për ne të marrim edhe kontributin e grupeve të interesit në mënyrë që ne si grup punues do të na shërbejë gjatë punës në proces të amendamentimit. Mendoj, që ajo arsyeja kryesore pse ne jemi para se të fillojë puna për plotësim ndryshim të projektligjit është që të marrin nga ju sugjerime apo ndonjë amendament që ne do ta inkorporojmë në ligj. Prandaj, më lejoni që kush ka dëshirë të marri fjalën, e keni fjalën. Faleminderit !

KRYETARJA , faleminderit, z Lekaj ! Unë dua të bëj të ditur që për këtë projektligj tashmë janë proceduar disa amendamente nga deputetët, një prej tyre jam edhe unë. Janë amendamente të cilat i ka propozuar BIRNI mirëpo unë këto i kam duke qenë me qëndrim të njëjtë me BIRNI-n i kam përpiluar si amendamente duke pas parasysh që përveç deputetëve, Presidentit, Qeverisë nuk kanë të drejtë shoqëria civile që të bëjnë amendamente, komente po por jo edhe amendamente. Duke qenë kështu unë i kam bërë tre amendamente dhe më lejoni që ti përmend dhe para jush. Amendamenti i parë është kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit në vend të tij hyjnë me zëvendësim bashkëshorti apo bashkëshortja dhe fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapare në Ligj nuk mund të jenë trashëgimtarët, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Amendamenti 2 është nëse paragrafi 2 i Nenit 28 i Ligjit bazik të fshihet në tërësi sepse bie ndesh me paragrafin 1 të po këtij neni. Arsyetimi është se nëse paragrafi i parë i ligjit bazik përkufizon të drejtën në trashëgimi të burrit dhe gruas që jetojnë në “bashkësi jashtëmartesore” njëjtë si burra dhe grua që jetojnë në “bashkësi martesore” atëherë pika 2 e nenit 28 të ligjit bazik bie ndesh dhe kufizon përcaktimin dhe fitimin e kësaj të drejte nga pika 1 dhe shpjegimet e saj në pikën

1.a dhe 1.b. Është e vështirë nëse nuk e keni projektligjin përpara por vetëm po e lexoj si amendament. Amendamente 3 Gratë dhe vajzat nuk kanë të drejtë heqje dore nga trashëgimia për një periudhë 10-vjeçare. D.m.th duke i parë praktikën deri tani kemi qenë të detyruar ndoshta të përpilojmë këto amendamente, natyrisht që kërkohet mbështetja e anëtarëve të komisionit por edhe Kuvendit në mënyrë që të njëjtat të kalojnë. Po ia kaloj tash fjalën, kush do nga anëtarët e komisionit të mare fjalën ? Edhe zonja Kadaj- Bujupi ka propozuar amendamente dhe ky është qëllimi se pse sot është në këtë dëgjim publik. A e dëshiron dikush fjalën,... jo nuk ka problem meqë komisioni njëherë po kërkon me i marrë qëndrimet e juaja atëherë po vazhdojmë me të pranishmit. Po vazhdojmë, vetëm ju lutem prezantohuni për shkak të transkriptit

VALBONA SALIHU, nga shoqata e juristëve 'Norma'. Shoqata 'Norma' për gati 20 vjet të aktivitete të saj mision kryesor ka mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi e veçanërisht të grave si kategori më e rrezikuar. Fillimisht me disa aktivitete tjera, tani jemi mbështet më së shumti edhe kur projektet të cilat i realizojmë në të drejtat e pronës apo trashëgimisë që ky takim është i mirëseardhur që ti shprehi disa nga mendimet tona. Në ndryshimet që janë propozuar po edhe që na keni treguar sigurisht që do të jap mendimin se po shihet se së paku gjykatat plotësisht po lirohen nga shqyrtimi i lëmisë së trashëgimisë. Unë po i cek menjëherë ato parimoret që mendoj se nuk është në rregull që plotësisht të hiqet kompetenca e gjykatës sepse për mua nuk do të kishte ndonjë dallim shumë të madh apo përparësi, apo lehtësim edhe për palët por edhe për institucionin nëse mbetet gjykata sikurse që ka qenë tani. Sigurisht që noteria pse jo të veprojë dhe të ketë kompetenca por jo të hiqet plotësisht kompetencat e gjykatës. Këtë unë kështu e krahasoj do të thotë si spitali publik dhe spitali privat që ka të drejtë të shkojë edhe atje edhe atje e veçanërisht për shkak të gjendjes ekonomike të popullatës siç dihet në Kosovë, se nuk kanë dhe kjo do të ishte një prej shkaqeve dhe arsyeve që gruaja veçanërisht që mos ketë qasje edhe në iniciimin e procedurës së Trashëgimisë.

Në gjykatat, ne s'ka një muaj që ne kemi vizituar disa gjykata për disa aktivitete dhe kemi parë se iniciimi i procedurës trashëgimore sado që të jetë vlera e masës trashëgimore është 20 € kurse në noteri është minimumi 50 dhe për iniciim dhe vetëm për propozim mund të rritet kjo taksë varësisht prej masës trashëgimore veç asaj që kur të merret vendimi që është edhe një shtesë, për një shtëpi p.sh. mund të shkojë tatimi deri në njëmijë € kurse në gjykatë do të ishte shumë ma e ulët, kjo është një nga arsyet e para, pastaj edhe shkaqet tjera se në noteri me përvojën tonë tani këto dy vitet e fundit që kemi hulumtuar se si po shqyrtohen dhe si po merren vendimet kemi parë që vërtet Oda e Noterisë nuk na ka dhënë mundësi që ti

shikojmë lëndët kështu që edhe kjo mos transparencë nga ana e odës do të ishte një prej minusave ta them në këtë arsye pse duhet të jetë edhe gjykata të ketë kompetencë.

Unë kam edhe propozime që e pash se edhe aty kishte... Albulena që i përmendi disa amendamente. Një prej tyre madje kush më njeh ka mbi dhjetë vjet që shkoj në atë se heqja dorë nga trashëgimia është një pengesë shumë e madhe për fuqizimin e gruas apo për barazinë gjinore në përgjithësi në Kosovë, është sepse se neni 1 i procedurës jo kontestimore që nuk bëhet iniciimi i trashëgimisë me anë të procedurës ex-oficio që do ta lehtësonte gruan që mos të shkoj ajo dhe të ketë, nuk ka aq guxim që të inicojë procedurën për shkaqe edhe i përmendi kryetarja e Komisionit, për shkaqe patriarkale dhe aq më keq që të marri guxim që ta shfrytëzojë të drejtën e trashëgimisë kështu që unë jam shumë ihtarë e asaj që ky nen për 10 vite, më së paku të ngrihet, mos të jetë në fuqi deri sa vetëdija e meshkujve deri diku të arrihet sepse unë kam parë edhe nga punët tona që shumica edhe nuk e dinë atë të drejtë. Mendojnë se me lindjen e tij është fituar ajo e drejtë dhe nuk ka ndryshim tjetër dhe me heqjen e kësaj do të ishte një përparim i madh.

Unë e di që me vetëdije, me punëtori, me çfarëdo forma tjera të vetëdijesimit do të arrihet kjo, por sigurisht do të shkojë decenie derisa vullnetarisht meshkujt ta pranojnë dh gruaja të ketë guxim më të madh.

Prandaj, me gjendjen e tashme do t'ishte një përparim i madh, një revolucion të them i shpejtë që brenda disa muajve në gjykatë të jenë të barabartë të gjithë trashëgimtarët dhe të jetë pastaj shprehia dhe që pas dhjetë viteve le të kthehet kjo dispozitë në fuqi, sepse unë e di që është shkelje e të drejtave të njeriut që ta detyrosh dikë të merr apo të mos merr, por unë e krahasoj edhe këtë me kuotën që është nëpër parti e asamble apo parlamente dhe edhe ajo është e shkelje e të drejtave të njeriut që çdo i treti e humbë të drejtën sepse gruaja duhet ta fitojë atë vend.

Pra edhe ajo është shkelje e të drejtave por për shkak të masës afirmative, për shkak të gjendjes që është, e bile bile e them shpesh edhe si vaksinë mund të jetë kjo sepse ka nevojë popullata që, ta them kushtimisht, të shërohet me fjalë dhe të jemi deri diku më afër, prandaj edhe nuk u kisha marrë kohë sepse nga përvoja jonë, edhe te intelektualët është tabu-temë nëpër familje ndarja e trashëgimisë së përbashkët, dhe mos të flas edhe për pronën e përbashkët, sepse edhe për atë kemi arsye të forta të flasim, por kjo është temë vetëm për trashëgiminë.

Pra, nuk do të marrë kohë më shumë, do të kisha folur ende, por kjo është e fundit që të amendamentohet dhe ju lus të gjithëve, kush ka fuqi dhe mund të ndikojë në këtë t'i japë rëndësi të madhe sepse pa barazinë në familje s'do të kemi barazi as në institucione, as në shoqëri dhe askund tjetër dhe nuk kemi të drejtë të kërkojmë të drejtat tjera kur vetë s'jemi të gatshëm që t'i ofrojmë ato të drejta. Faleminderit tash për tash!

KRYETARJA: Faleminderit zonja Salihu për kontributin! Kush e do tjetër fjalën nga të pranishmit? Fjalën e ka zonja Kadaj Bujupi!

DONIKA KADAJ –BUJUPI: Faleminderit! Përshëndetje për të pranishmit!

Vërtet është një temë të cilën e kemi trajtuar pothuajse për një dekadë, e organizatat para neve, menjëherë pas luftës, e ne që më vonë mbërritëm në Parlament e trajtuam ndoshta edhe kështu nga aspekti emocional duke e parë se moszbatimi i ligjit, në fakt këtë problem po e bartë edhe te vajzat tona.

Realisht, jo pse jemi keq, por po prapakthehemi. Dhe, nëse i shohim shifrat, do të vërejm, që, shembull në vitin 2012 kanë qenë vetëm 2% të grave të cilat kanë poseduar pronë dhe rrjedhimisht e kanë shfrytëzuar të drejtën e paraparë me ligj për të pasur trashëgimi.

Në vitin 2015 kjo është ngritur për 3% dhe do të thotë se diku vetëm 5% të grave e gëzojnë të drejtën e tyre për pronë ose trashëgimi, që është tepër pak dhe ne nuk mund të flasim për barazi gjinore në rast se s'kemi barazi ekonomike, në rend të parë, dhe mundësi të barabarta.

E kam bërë një përlllogaritje, edhe pse s'jam shumë e mirë në matematikë, por nëse vazhdon ky trend do të na duhen mbi 100 vite që ligji të zbatohet në tërësi.

Dhe tash merreni me mend sa vonë jemi dhe sa prapa rajonit, e lëre më Evropës gjendemi si Kosovë me këto trende kryesisht për shkak të ndikimit, do të thosha të Kanunit, një mendësi shumë konservative dhe patriarkale e cila nuk po ndërron, as në fshat e as në qytet.

Prandaj, janë dy mënyra që këtë ta bëjmë. E para është me ligj dhe me amendamente të cilat ne si Grup Parlamentar i kemi propozuar Albulenë mbi 5. Pra janë rreth 5 amendamente, 3 veç se u lexuan, janë edhe 2 shtesë dhe mendojmë që kjo do të jetë në rend të parë për të lobuar e punuar që këto amendamente të përkrahen.

Unë isha e befasuar herën e fundit kur diskutimet tona nuk u përkrahën ose u kundërshtuan madje edhe nga disa kolege deputete të cilat edhe vetë janë, kushtimisht po e them - viktimë e moszbatimit të këtij ligji por megjithatë pres që pas një diskutimi të mirëfilltë në seancën në të cilën do të shqyrtohet projektligji në fjalë të na përkrahin dhe të gjitha këto amendamente – plus amendamentet tjera që presin të vijnë edhe nga grupe tjera parlamentare të përkrahen dhe bashkë ta bëjmë një ndryshim.

Dhe e dyta, të cilën e kemi diskutuar aq shumë, kur e kemi një ligj të tillë, kaq të ndjeshëm, në një shoqëri si shoqëria jonë është tepër e rëndësishme që të ndërmarim edhe masa afirmative të cilat do të gjejnë mënyrën e zbatimit të këtij ligji.

Ne në vitin 2012 bashkë me gratë deputete e patëm nxjerrë një rezolutë e cila parashihte shfrytëzimin e IPA fondeve për zbatimin e Ligjit për trashëgimi dhe pronë.

Dikujt mund t'i duket e çuditshme sepse s'e ka dëgjuar por, për shembull, Kroacia përmes këtyre fondeve të cilat kryesisht jepen nga Bashkimi Evropian për demokratizim të vendeve para anëtarësimit, në fakt janë shfrytëzuar për zbatimin e Ligjit të trashëgimisë dhe pronës.

Si ka ndodhë kjo? Thjeshtë përmes subvencionimit të bizneseve të grave të cilat kanë poseduar kolateral. Rrjedhimisht kanë pasur pronë në emër të vetin.

Dhe çka ka ndodhë? Për shembull, sivjet, janë rreth 200 milionë euro të paraparë në Bashkimin Evropian të ndahen për Kosovën lidhur me çështjen që lidhen me gjyqësinë, me demokratizimin e shoqërisë, me barazinë gjinore e çështje të tjera fort të rëndësishme të cilat ne, jo çdo herë mbërrijmë t'i konsumojmë për shkak se kemi shumë pak përgatitje ose shumë pak kapacitete që të përgatisim projekte adekuate dhe të aplikojmë me to, po ngecin. Shembull Serbia, është ven e cila në rajon ka mbërri t'i konsumojë këto fonde ndoshta më shumë se të gjitha ish republikat e Jugosllavisë bashkë për shkak se ka ngritur kapacitete të mjaftueshme administrative dhe kanë punuar në këtë drejtim, kurse ne si Kosovë kemi ngecur dhe në rastin konkret përderisa kemi një shembull se si ka vepruar Kroacia, ajo rezolutë e nxjerrë në vitin 2012 nuk ka gjetur implementim dhe ekzekutivi nuk ka ndërmarë asnjë veprim që përmes projekteve të tilla të mbërrijmë që jo vetëm gratë por familja në përgjithësi të përfitojë, sepse imagjinoni në një situatë kështu

hipotetike në rast që mundësohet një grand për një projekt të caktuar ose për një biznes të një gruaje qoftë në prodhim, qoftë në bujqësi, qoftë në blegtori, qoftë në ferma sepse po shohim nga takimet e shumta që ka shumë gra fermere të cilat problemin kryesor e kanë se nuk posedojnë pronë kolateral, nuk kanë qasje në kredi, kreditë janë tepër të larta atëherë kur i marrin dhe në një situatë tjetër kur do të ofroreshin grande kundruall kolateralit ose posedimit të pronës, jam shumë e bindur sepse kështu ka ndodhur edhe në vende tjera që vetë burrat, pavarësisht mendësisë ose së kaluarës, do të pajtohen që ajo pronë të jetë në emër të gruas, të jetë në emër të një anëtarit të familjes dhe vullnetarisht do ta përkthenin, sepse përfitimi për familjen është jashtëzakonisht i madh.

Kjo fillimisht und të duket ashtu artificiale, por në fund të fundit edhe kuotat në parlament kanë qenë të tilla deri sa nuk kemi mbërrirë të futemi në Parlament me votat tona vit pas viti më shumë.

Do të thotë janë masa afirmative në shoqëri të cilat për një arsye të caktuar nuk funksionojnë në një sektor të caktuar.

Dhe, kjo do të ishte ndoshta një rikujtim i përpjekjeve tona edhe nga e kaluara, pra të grave deputete të cilat ka ngjarë kryesisht për shkak të mungesës së zbatimit nga ana e ekzekutivit dhe ndoshta një mundësi që ta rifillojmë këtë përpjekje bashkë edhe me shoqërinë civile dhe me të gjitha institucionet relevante në mënyrë që konkretisht përtej fushatave të vetëdijesimit ndoshta edhe përtej këtij ligji i cili patjetër se duhet të jetë bazë në të kaluarë në një fazë tjetër e cila do të mundësojë që subvencionimi dhe përkrahja e atyre grave të cilat marrin guximin dhe mbërrijnë të posedojnë një pronë, në fakt të shpërblehet ose përkrahet në mënyrë që kjo të kalojë në një fenomen.

Unë kam biseduar me komunën e Prishtinës dhe ata janë të gatshëm të jenë pilotë komunë sepse kanë edhe kapacitete njerëzore por kanë edhe vullnet të fillojnë në kryeqytet mirëpo sigurisht se do të duhej të kenë një përkrahje më të madhe edhe nga Qeveria dhe sidomos nga komisioni dhe Zyra e BE-së të cilat në njëfarë forme i përcaktojnë prioritetet për Kosovën.

Amendamentet nuk do t'i lexoj për të mos ju lodhur, sepse do ta bëjmë këtë në Parlament, dhe në ndërkohë veç sa janë të dorëzuara dhe janë , prandaj besoj dhe thërras që edhe ju të na ndihmoni që përtej 30 votave si opozitë të fitojmë përkrahjen edhe të deputetëve tjerë.

KRYETARJA: Faleminderit! Si po shkon situata, nuk di se këto ligje dotë kenë fatin të kalojnë në Kuvend për faktin se sipas Rregullores do të kthehen prej fillimit dhe mendoj që ndoshta Minisria e Drejtësisë nuk do të na lodhte shumë të bëjmë amendamente, por do t'i bënte vet, e ne do t'i votonim.

Megjithatë, ne po punojmë sa të zgjatë kjo legjislaturë, dhe uroj sa më pak.

(Ndërhyrje)

Natyrisht! Atëherë po ia japim fjalën përfaqësuesit nga ministria.... Kërkoj ndjes...

XHEVAT AZEMI: Unë jam Xhevat Azemi! Punoj në programin për të drejtapronësore të USAID-it....

KRYETARJA: Më falni, a keni punuar në Ministri apo jo?

XHEVAT AZEMI: jo. Në Agjenci për Pronat!.

XHEVAT AZEMI: Mirëpo, kemi bashkëpunuar me Minitrinë për shkak se Minisria e Drejtësisë është një nga përfituesit e programit tonë. Detyra e parë në Programin për të drejta pronësore të USAID-it ka qenë rishikimi i politikave të sektorit të drejtave pronësore dhe hartimi i strategjisë për sektorin e të drejtave pronësore.

Strategjia është aprovuar në muajin janar të këtij viti. Është vlerësuar se është një punë shumë gjithëpërfshirëse dhe shumë transparente, kanë marrë pjesë mbi 100 ekspertë në hartimin e kësaj strategjie dhe tash programi ynë është duke punuar në zbatimin e saj. Do të thotë krahas strategjisë është bërë edhe plani i veprimit dhe po mendohet që deri sa të zgjatë ky program të punohet intensivisht në zbatimin e kësaj strategjie.

Lidhur me këtë projektligj do të thosha se para hartimit të strategjisë për çdo temë që harton strategjia janë bërë analiza të detajizuara dhe në shumë raste janë angazhuar edhe organizata joqeveritare si bashkëpunëtorë të programi, por edhe kompani t ndryshme dhe ka rezultuar se çështja e zbtimit të ligjit të noterisë, ligjit përprocedurë jokontestimore dhe ligj i trashëgimisë ka probleme për shkak se pas aprovimit të ligjit për noterinë në vitin 2008 i cili ka filluar të zbatohet në vitin 2012 asnjëherë nuk është bërë harmonizimi i ligjit të trashëgimisë dhe ligjit të procedurën jokontestimore me atë ligj.

Do të thotë, kemi pasur një ligj të noterisë i cili përmban dispozita jo shumë të qarta dhe dispozita të përgjithësuara të cilat mund të interpretohen kush qysh do dhe tash ka interpretime se noterët s'kanë të drejtë të bëjnë procedura trashëgimore për shkak se formulimi në atë ligj është shumë i përgjithësuar dhe shumë i cekët. E dyta. Nëse shikohet vetëm ligji për trashëgiminë atëherë del se vetëm gjykatat kanë të drejtë të bëjnë trashëgiminë ose Ligji për procedurë jokontestimore.

Prandaj, në analizat që janë bërë por edhe në strategji është paraparë që të harmonizohen këto ligje dhe gjithashtu të shikohet të parashihen apo ndërmerren masa sigurie edhe për çështjen e mbrojtjes së drejtave të grave.

Projektligjet janë punuar si pako, të tria përnjëherë. – trashëgimia, noteria dhe procedura jokontestimore dhe nëse lexohen si të veçanta atëherë krijohet përshtypja se ka mangësi shumë, sepse qysh zhvillohet procedura e parasheh ligji për procedurë jokontestimore, jo krejt ligji i noterisë.

Këtë po e them për shkak se kam parë komente sikur që është bërë një koment në projektligj të trashëgimisë i cili për një çështje që është rregulluar me projektligjin për procedurë jokontestimore....

Prandaj lutja ime është që kur të punohen këto të harmonizohet. Është mirë që filluam me noterinë por të harmonizohet dhe shikohet që mos të dyfishohen dispozitat

Në një nga analizat që është punuar para hartimit të strategjisë është është një analizë e veçantë për çështjen e heqjes dorë. Ka pasur mendime se neni 130 të fshihet....., pra i Ligji për trashëgimi ku parashihet heqja dorë....por ka mbizotëruar qëndrimi që ka pasur të angazhuar edhe ekspertë vendorë e ndërkombëtarë që kjo kishte me qenë shkelje e të drejtës së njeriut nëse i imponohet diçka pa dëshirën e tij.

Duhet të kemi parasysh se nganjëherë në trashëgimi ka edhe obligime, jo veç të drejta. Bile ka shumë raste që ka më shumë obligime ku ngarkesat e pronës janë më të mëdha se sa vetë vlera e pronës. Megjithatë, ajo s'është arsye por është arsye se konsiderohet që çdokush mund të vendosë vet, me vullnetin e tij a dëshiron të ketë pronë apo s'dëshiron.

Janë brengosëse statistikat. Zonja deputete Kada-Bujupi i prezantoi, por ato statistika kanë të bëjnë me trashëgiminë, kurse gratë apo femrat posedojnë diku 18.7% të pronave në Kosovë.

Kush merret me statistika mund të shohë se prej fillimit të dhënies së grandeve e subvencioneve nga komuna dhe Ministria e Bujqësisë ka filluar të rritet në mënyrë të ndjeshme regjistrimi i pronave në emër të femrave për shkak s'parashihen diku, mos gabofsha 5 poena ma shumë për orientimin për përfitimin e grandeve. Do të thotë, duhet të krijojë motive, ose së par duhet të krijojmë siguri që gjithkush është i informuar dhe mandej duhet përveç masave të sigurisë të krijojë motiv sepse pa motiv nuk do ta regjistrojnë as gratë por edhe shumë meshkuj s'do ta regjistrojnë. Unë shpesh e tregoj se prona që mua ma ka lënë baba im është e regjistruar në emër të gjyshes time. Do të thotë në emër të një femre është regjistruar në vitet e 60-ta.

Po edhe atëherë ka qenë një motiv. Baba o kanë i punësuar, nuk i kishte marrë shtesat e fëmijëve mos ta kishte regjistruar në emër të gjyshes.

Do të thotë duhet t'i motivojmë motrat tona, gratë tona që të punojnë. Grandet e subvencionet janë një prej motivimeve.

Në këto tri projektligje, nëse lexohen si të përbashkëta çështja e parë që është trajtuar është çështja e përjashtimit. Për mua më e vështira është dhe më shumë i dëmton të drejtat pronësore të grave përjashtimi nga akti i vdekjes apo që tash i thonë dëshmia e vdekjes sepse kemi kundërthënie edhe me ligjin për regjistrat civilë, ku një prej trashëgimtarëve shkon në zyrën e gjendjes civile dhe vetë e plotëson formularin e aktit të vdekjes dhe e plotëson qysh të donë dhe si të tillë ia vërteton zyra e regjistrat civil. Do të thotë e kanë shndërruar aktin e vdekjes në dokument deklarativ, që nuk është.

Ligji parasheh, ai i trashëgimisë dhe i procedurës së zyrës kontestimore, po sidomos ai i procedurës të zyrës kontestimore që akti i vdekjes të nxirret nga regjistrat civil dhe të hartohet nga zyrtari regjistrat civil, që mos me mund ta përjashtojë.

Nëse një motër a një grua nuk shënohet në aktin e vdekjes ajo s do të ketë rast hiç të shkojë në gjykatë të deklarohet a do pasuri a nuk do.

Pra në këto projektligje parashihet ky nen.

Çështja e dytë, te heqja dorë. Meqenëse ka qenë konkluzion i shumicës së ekspertëve që heqja dorë është shkelje e së drejtës të njeriut, atëherë ne e kemi dëmin praktik apo dëmin në praktikë që po heqin dorë sidomos gratë dhe është tentuar që të krijohen do masa sigurie që të sigurohet se çdo person e sidomos gratë fillimisht të jenë të njoftuara për procesin e trashëgimisë. Në Ligjin për procedurë jokontestimore janë paraparë edhe dispozita shtesë që përveç njoftimit m e ftesë ose inicimit të procedurës me u bë edhe publikimet e procedurave të trashëgimisë, që me mund gjithkush të jetë informuar dhe nëse ndokush për çdo rast nuk është përfshi në aktin e vdekjes të shkojë të paraqitet te noteri dhe të merr pjesë në procedurë. Mandej është paraparë që noterët të jenë të obliguar ta mbajnë një sesion informues me të gjithë trashëgimtarët, t'i njoftojnë të gjithë për të drejtat që i kanë, drejtat që ua ofron ligji, t'i njoftojnë se në zbatim është ligji, jo kanuni qysh ka herë interpretohet, dhe të sigurohen se çdokush është i njoftuar me të drejtat...

Nëse ndonjë nga trashëgimtarët prapë insiston që heq dorë në projektligjin për procedurën kontestimore parashihet që të mbahet një seancë e veçantë me atë trashëgimtar, dhe thuhet në propozim të nenit të mbahet seancë vetëm me të dhe të tentohen të nxirren arsyet pse po heq dorë, a ka dhunë nga familja, a ka kërcënim, a ika thënë vëllai që ti më në shtëpi timen s'mund të hysh dhe gjithashtu parashihet në projektligj, nëse noteri vjen te informata se ka kërcënim është obliguar ta njoftojë prokurorinë, sepse kërcënimi apo detyrimi me dhunë me bë diçka është vepër penale.

Ka pasur interpretime se kjo dihet që është në kod penal dhe s'ka nevojë të shtihet at, mirëpo po mendojmë se është mirë edhe noteri kur ta lexojë ligjin të shohë se ka obligim, po edhe unë si një trashëgimtar kur të di se noteri ka obligim të më lajmërojë nuk do ta përjashtojë dikë ose nuk do ta kërcënojë dikë me heqë dorë.

Gjithashtu është zvogëluar periudha kohore e fitimit të drejtës së trashëgimisë për bashkësitë jo martesore. Është marrë përvoja e shumicës së shteteve të BES=ë, nga 10 vjet është propozuar të bëhet 5 vjet, dhe nga 5 vjet kur ka fëmijë është propozuar të bëhet 3 vjet. Po ashtu është konsideruar se te heqja dorë në emër të fëmijëve të mitur, në ligjin aktual thuhet që s'ka nevojë të jetë prezent organi i kujdestarisë dhe mendimi është se është e nevojshme të jetë prezent organi i kujdestarisë sepse nganjëherë në atë mllëfin e ndarjes apo në atë mllëfin e problemeve familjare nganjëherë hiqet dorë dhe dëmtohet edhe fëmijët për shkak të heqjes dorë.

Ne si program, kur është punuar ligji e kemi propozuar edhe një nen që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortit pas jetues.

Përveç kësaj që zonja haxhiu e paraqiti te rasti i amendamenti i Birrnit ne kemi menduar që të jetë edhe një nen apo një paragraf në kuadër të nenit 12 aktual i cili ka të bëjë me krijimin e një sigurie për bashkëshortin pas jetesës, edhe në rastin kur ai ka të drejtë në trashëgimi, ka raste që bashkëshortja apo bashkëshortja pas jetesës në procesin e ndarjes së trashëgimisë nuk fiton të drejtë në shtëpinë e banimit. Dhe mund të jetë jashtë, edhe pse ajo e ka një pjesë të trashëgimisë dhe është propozuar një nen që thotë nëse bashkëshorti pas jetesës nuk ka objekt për banim, ai mban të drejtën e tij apo të saj të përdor objektin banesor martesor në të cilin ka jetuar gjatë martesës deri në vdekje ose rimartesë.

Është paraparë edhe çka në rastin nëse ai i cili e ka trashëguar objektin do ta shesë apo do të bëjë një zgjidhje tjetër, atëherë parashihet që gjithashtu me të sigurohet një strehim bashkëshortit pas jetesës.

Dje e kam përcjell këtë në administratën e Kuvendit, kur e kam marrë ftesën dhe mendoj që edhe Ministria tash është pajtuar me këtë nen dhe ndoshta edhe Ministria e propozon si propozim ose ju si deputetë...

Ne mendojmë se është mirë me u prezantua. Përveç rastit që me i krijue të drejtë trashëgime bashkëshortes ose bashkëshortit kur nuk ka fëmijë, atë që e prezantuat, të hyjë edhe ky paragraf që mos me lënë bashkëshortin pas jetesës në rrugë, pavarësisht që ai apo ajo e ka marrë një pjesë të trashëgimisë.

Për mos me ju lodhë më shumë besoj se kur të shqyrtohet projektligji nen për nen mund me kontribue.

Kishte me qenë mirë që këto projektligje mi kalue para zgjedhjeve, pavarësisht kur mbahen sepse ne po flasim për shkak se nëse vonohen realisht ka probleme në praktikë dhe problem të shumta në praktikë, ka mospërputhje të ligjeve dhe sidoqoftë këto ligje po parashohin do masa sigurie edhe për temat për të cilat po flasim për ditë.

Ne mund të flasim përveç vetëdijesimit të opinionit, nëse ne nuk krijojmë bazë ligjore të mirë, faktikisht veç opinionit nuk mjafton për t'i mbrojtur të drejtat e dikujt sepse mundet një grua, një motër, me thënë j- po unë dua, por nëse shkon në procedurë dhe faktikisht i bëhen obstrukcione apo nuk hyn në akt vdekje, nuk ka shans me shkua hiq, kështu që këto nuk kanë të bëjnë shumë me politika të gjera por politikë të këtij sektori dhe me i mbrojt të drejtat e njerëzve.

Tash në fillim ka dilema me çfarë akti vendosin noterët kur e bëjnë trashëgiminë, a kanë të drejtë ta bëjnë apo s'kanë, t'ielimonojhmë këto dilema e të fillojmë të krijojmë një rregull në këtë sektor.

Çështja pse në projektligjin për noteri është paraparë në trashëgimi vetëm mandati i noterëve te procedura trashëgimore jo kontestimore, ndoshta qe një vit ka pritur projektligji për këtë vendim nga ministria.

Gjykata nuk është përjashtuar por gjykata merret me rastet kontestimore. Arsye pse janë paraparë veç noterët është që në bazë të analizave që i përmenda më herët është gjetur që diku rreth 30% të pronave në Kosovë janë në emër të personave të vdekur.

Do të thotë kemi një formalitet jashtëzakonisht të madh. Janë diku rreth 15% të pronave që janë ble dhe asnjëherë nuk është formalizuar blerja sepse janë ble me kontrata jo formale.

Nëse n dëshirojmë t'i formalizojmë këto kontrata, që mund të bëhen vetëm përmes gjykate, apo dëshirojmë të bëjmë një trashëgimi, duhet me prit nja 4 - vjet në gjykatë për shkak të ngarkesave të gjykatave tona, atëherë kjo i demotivon njerëzit të bëjnë procedurë të trashëgimisë. Ka raste në praktikë që është bërë propozimi para 6 – 7vjetëve dhe ende është duke pritur lënda, sidomos në qytetet e mëdha dhe ideja është që nëse është procedura jo kontestimore, nëse trashëgimtarët nuk kanë asnjë kontest rreth ndarjes së pasurisë së tyre, atëherë procedura te noteri është shumë më e lehtë dhe kryhet më shpejt.

Është relative a është më e shtrenjtë. Nëse e merrni ju nujëaktgjykim tzë gjykatës me shku me regjistruë në kadastër kushton 50 euro, e një vendim i noterit me regjistrue në kadasastër pasi të kryhet procedura kushton 20. Do të thotë janë kontrata me tarifa.

Te çështja ma e shtrenjtë, unë u mundova mos me hy, dhe ndoshta s'kemi kohë sot të hyjmë në detale,në projektligj të noterisë faktikisht ka qenë një ide që tarifat e noterëve të jetë tarifë kushtuese, jo tarifë qysh është tash,e që në fakt nuk ishte kërkund në shtetet e B-E-së është bërë një analizë, përafërsisht dhe nuk është vetëm tarifë kushtuese mirëpo në projektligj është paraparë kur është bërë udhëzimi administrativ janë marrë shembuj disa shtete dhe në këtë shtet është qëkaq po e bëjmë edhe ne qëkaq.

Në projektligj të noterisë, normal nëse kalon është paraparë një paragraf që thuhet që tarifat e noterëve duhet të reflektojnë të hyrat vjetore mesatare në Kosovë.

Nuk mundemi ne të krahasohemi me Gjermaninë, me thënë i ka Gjermania tarifat 100 euro me vërtetue një akt, me e bë edhe ne 100, nëse të hyrat atje ose GDP është krejt tjetër prej të hyrave këtu, kështu që me këtë po dua të them s'është çështje që me projektligj thuhet se Ministria i cakto tarifat por unë mendoj se duhet të rishikohen ato tarifa dhe me kanë të kapshme për xhepin e kosovarëve.

Edhe fjalia e fundit, nganjëherë ligjet ose projektligjet duken që nuk përshtaten me ndonjë shtet të zhvilluar mirëpo ne duhet t'ia përshtatemi kushteve të Kosovës. Nëse ne e kemi joformalitetin 45 deri 50% atëherë duhet të lehtësojmë procedura, duhet të ulim çmime dhe duhet të krijojmë kushte që ky joformalitet të zvogëlohet në masën sa më shumë të mundshme e mandej krijojmë procedura sa domi dhe sa mundemi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Sa i përket tarifave kjo është arsyeja se pse ne si grup parlamentar nuk e patëm përkrahur projektligjin për procedurën jo kontestimore për shkak se nuk i është lënë mundësia që pala në qoftë se nuk ia mban xhepi t'i drejtohet gjykatës por është lënë vetëm tek noterët.

Nuk mund të krahasohemi me vendet e Bashkimit Evropian për shkak se standardi atje është jashtëzakonisht më i lartë. Tash të gjithë jemi dëshmitarë... Pra, sa i përket tarifave të noterëve e kam pasur një rast... Unë jam deputete dhe deputetët kanë paga megjithatë të mira, dhe më janë kërkuar 100 euro për të autorizuar nënën time për ta marrë djalin në Shqipëri, do të thotë me ia bë autorizimin. Tash, në qoftë se unë si deputete hoqa dorë nga ai autorizim, do të thotë e anulova, atëherë merreni me mend një qytetar i cili e ka rrogën mesatare 370 euro, ose që s'ka të ardhura fare. Pra, duhet patjetër të shikohen këto tarifa për shkak se janë jashtëzakonisht shumë të larta.

(Ndërhyrje)

Mua mi kanë kërkuar 100 euro. Emrin e noterit nuk dua ta përmendi, sepse s'është etike, mirëpo 100 euro mi kanë kërkuar për ta bërë një autorizim dhe mu ka dukur shumë jashtëzakonisht e lartë dhe absurde.

(Ndërhyrje)

Unë po tregoj qysh më kanë thënë dhe hoqa dorë komplet.

Zonja Kada shkurt, e pastaj e merr fjalën përfaqësuesi nga Birrni, sepse po u ngatërroj edhe juve.

KADA BUJUPI: Pal s'po di sa parasheh, por qe, po domi të diskutojmë. Desha, pasi jeni në programin Eusaid-i, realisht nga takimet e shumta që i kemi ne me gra fermere kanë dalë disa shqetësime serioze për këtë çështje, se pop pajtohem që barrierat kulturore po bien kur po përfiton familja dhe kjo po ndodh për shkak të 5 pikëve, apo jo.

Tash këto 5pikë do të ishte situatë kaq dramatike po e them, se është e tillë kur shifrat flasin se bëhet fjalë për një diskriminim shumë të madh, këto 5 pikë të rriten, për shembull në 20 pikë, sepse kërkohen gjithsej 90 pikë për ta fituar grandin.

Dhe nëse 5 pikë më shumë shkojnë për një pronë e cila është në emër të gruas, sigurisht sedo të ndërronte gjendja nëse ato 5 pikë shndërrohen në 20 pikë shtesë.

Dhe tjetra, është prapë një diskriminim për gratë këtu sepse nën një kërkohet shkolla e mesme e shumë prej fermereve nuk e kanë shkollën e mesme dhe është tepër diskriminuese dhe nuk e kanë, domethënë është një situatë goxha kështu në kundërshtim me realitetin e grave të Kosovës Dhe e dyta, mosha është përsëri diskriminuese, sepse përcaktohet – dhe thotë i jepet përparësi grave deri në moshën, sikur më duket 37 – 38 vjeç.

Tash gratë mbi moshën 40 vjeçare janë vitale për të fituar fermere dhe me u mohuar e drejta për të pasur çasje në një grand sepse është mbi ose nën moshën 38 vjeçare, është diskriminim, është edhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut.

Tash ne jemi ankuar gjatë gjithë kohës pse janë kërkuar asistentet prej 25 deri 35, por fermeret me thënë e merë një grand nëse je nën moshën 37 – 38, kështu në njëfarë moshe shumë e re, përnjëmend është diskriminuese dhe në kundërshtim me realitetin në terren.

E tash ne pasi po flasim për Kosovën dhe nevoja e Kosovës, dhe s'po domi ta përgjithësojmë sikur po thotë Pali në Evropë e në rajon, atëherë duhet me i pa problemet reale të cilat gratë fermere edhe kur aplikojnë në emër të tyre për shkak se posedojnë pronë në fakt ballafaqohen me diskriminim të dyfishtë në këto dy çështje.

Ndoshta ka qenë me rëndësi edhe këto dy pika me i trajtuar, me qenë në program ndoshta jo drejtpërdrejt por keni qasje dhe mundeni në rishikimin e kriterëve me e përfshi edhe këtë ndryshim.

KRYETARJA: Faleminderit! Edhe sot ndodhi që projektligjet të cilat janë proceduar në Kuvend u mbrojtën dhe nga Këshilli i Evropës, sot nga USAID-i, diqysh sipas kushtetutës të drejtën për të propozuar ligje e ka Qeveria, deputetët, presidenti, grupet parlamentare, dhe unë nuk jam kundër kurrëgjë, faleminderit për informacionet, por s'po dihet kush po i shkruan ligjet, do të thotë a është shkruar nga Ministria e Drejtësisë dhe janë marrë parasysh komentet tuaja, apo si qëndron puna? Sepse, përnjëmend në qoftë se kështu vazhdon atëherë është goxha problematike, sepse po dihet që s'paska pasur gisht ndoshta Ministria e Drejtësisë në këtë drejtim, por organizatat të cilat i mbështesin punën e Qeverisë.

Përfaqësuesi nga Birni!

LABINOT LEPOSHTICA: Faleminderit kryetare! Jam Labinot Leposhtica, përfaqësues zyrtar ligjor në Birn.

Fillimisht, po më vjen shumë mirë që njëri prej rekomandimeve tona për Ligjin për trashëgiminë gjeti mbështetje edhe nga ju.

Ky njëkohësisht ka qenë rekomandimi ynë kryesor që e drejta e përfaqësimit qysh njihet ndryshe, t'i njihet edhe grave ose mos të ngushtojë edhe bashkëshortit, në raste kur pasuria është në emër të trashëgimlënësit e ai, para tij ka vdekur fëmija i tij. Në këtë rast, rasti i Shyhrete Berishes na e ka dhënë këtë leksion.

Fatmirësisht ne e kemi projektin të monitorimit të gjykatave që 10 vjet dhe prej kësaj ky ka qenë rekomandimi kryesor i rekomandimeve tona, prej monitorimit në praktikë të zbatimit të këtyre ligjeve kanë buruar edhe rekomandimet tona.

Përpos këtij rekomandimi që gjeti mbështetje nga ju ne i kemi propozuar edhe disa rekomandime tjera në këtë projektligj që po du t'i përmendi shkurtimisht për të mos ju marrë juve shumë kohë. Shembull e kemi gjet që në ligjin aktual për trashëgimi në Kosovë, neni 114 përmban një dispozitë të tillë, e cila është si në vijim:

Një trashëgimtar, do të thotë, mund të përjashtohet nga e drejta e trashëgimit në qoftë se është plan prishës, nuk do të punojë ose është dhënë pas jetës së pandershme.

(Ndërhyrje)

Cili është autoriteti i cili e përkufizon jetën e pandershme në këtë rast? Kjo mund të shfrytëzohet dhe kemi pasur raste kur është shfrytëzuar prej trashëgimtarëve të caktuar, zakonisht në dëm të grave apo vajzave që ato të përjashtohen prej trashëgimisë.

Një dispozitë si kjo absolutisht nuk mund të qëndrojë dhe nuk as tash të ekzistojë, dhe nuk di si paarritur të hyjë kjo në ligji.

Sigurisht propozojmë që kjo duhet të hiqet dhe largohet prej ligjet me ndryshimet që parashihen në këtë projektligj.

Ndryshim ose rekomandim tjetër që ne e kemi propozuar është një masë e sigurisë të cilën e kemi propozuar të futet edhe në Ligjin për noterinë por edhe për procedurën jokontestimore.

Duke ditur se kemi pasur raste kur palët janë ankuar direkt në gjyqtarin apo edhe noterin që i ka keq udhëzuar ose pyetja për heqje dorë nga trashëgimia i është parashtruar në atë formë që trashëgimtarja është udhëzuar në njëfarë forme kemi propozuar që seanca, sidomos seanca informuese dhe seanca për heqje dorë nga trashëgimia të jetë e filmuar, pra përpos procesverbalit të jetë edhe e filmuar me video dhe audio incizim.

Ne prej analizave tona nuk kemi pa se ekziston ndonjë pengesë ligjore që kjo të bëhet.

Këto filmime dhe video incizime do të ruhen në arkivën e noterit, dhe do të kishte qasje vetëm pala me kërkesë të saj edhe noteri, apo edhe ndonjë institucion publik, shembull nëse rasti shkon në gjykatë dhe është kontestuese që pala është udhëzuar keq prej noterit, atëherë këto filmime kishin mund të jenë provë të rëndësishme.

Ne nuk kemi pa ndonjë mekanizëm tjetër ose masë të sigurisë që një grua, e cila është keq udhëzuar, një grua që, të themi, nuk ka njohuri juridike ose nuk ka njohuri për pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia, kishte mund t'i përdorë kundër një noterit që e ka udhëzuar keq, sidomos tash me ndryshimet e reja që parashihen që seanca informuese të jetë vetëm noteri dhe pala e cila heq dorë.

Këto pak a shumë janë rekomandimet tona. Ne do të jemi pjesë aktive e grupeve punuese, edhe në këtë ligj, po edhe në ligjin për procedurë jokontestimore e noteri dhe kemi me vazhdu të japim kontributin tonë.

KRYETARJA: Faleminderit! Po ashtu do të ftoheni edhe në grupet punuese për të dhënë kontributin, vetëm më lejoni të ju informoj se edhe këto rekomandime që u përmendën janë bërë amendamente dhe çështja e dëshmitarëve që nuk mund të jenë familjarë të rrethit të ngushtë, por edhe video incizimet për faktin se sot jemi dëshmitarë që për të hequr dorë nga trashëgimia bëhet goxha njëfarë presioni mbi vajzat e gratë dhe kjo është arsyeja se pse duhet të ketë edhe video incizim në kohën kur gratë dhe vajzat heqin dorë nga trashëgimia.

Presioni natyrisht se vërehet aty, është i dukshëm. Tash po ia kaloj fjalën deputetit Agim Aliu, pastaj përfaqësuesit nga OSBE-a dhe pastaj ju Polis. Dakord! Atëherë, Agim Aliu, Përfaqësuesi nga OSBE dhe ju...

_AGIM ALIU: Faleminderit zonja kryetare!

Përsëndetje për kolegët dhe të gjithë të pranishmit!

Bukur shpesh jemi ballafaquar gjatë këtij legjislacioni me ndryshime dhe plotësime dhe na kanë penguar ndryshimet dhe plotësimet për shkak se na kanë kufizuar lidhur me atë se sa do të duhej të ishte masa e ndryshimit.

Dhe kur e kemi masë të kufizuar të masës së ndryshimit, nuk e di sa kemi mund pastaj t'i prodhojmë efektet që do të duhej të ndryshonin gjendjen për shkak edhe ligji, apo sa na kanë shërbyer ligjet aktuale që të identifikohen problemet në mënyrë që pastaj të zgjidhen ato përmes një ndryshimi dhe plotësimi.

Jemi po ashtu edhe në një plotësim e ndryshim të një projektligji për trashëgiminë i cili nuk e di sa na lejon ose sa na mundëson ose sa ne do të jemi efikas përmes amendamenteve dhe përmes këtyre diskutimeve që pastaj sigurisht se do të bëhen amendamente dhe grupi punues dhe komisioni do t'i ketë parasysh që të realizojmë atë qëllim dhe synim për të ndryshuar gjendjen.

Unë mendoj se ne mund të organizohemi jo vetëm në seanca dëgjimore të këtij lloji por edhe debate e debate të tëra dhe ne krejt e dimë gjendjen çfarë është lidhur me trashëgiminë dhe me gjendjen e përgjithshme të femrës dhe gruas shqiptare.

Mirëpo, unë mendoj se nuk rregullohen këto çështje në mënyrë nganjëherë ne qysh po diskutojmë.

Unë kam konsideratë për secilin diskutim dhe për secilën qasje por vetë shembujt këtu dolën paksa kontradiktor në kuptimin e asaj se si do të duhej të ndryshohej gjendja.

Unë mendoj se ligji duhet të jetë garanci e forcimit të rolit të gruas në shoqëri. Gjykatat duhet të jenë garanci e ndryshimit të rolit të gruas në shoqëri, kur ato duhet të shtojnë efikasitetin dhe efektivitetin e punës së tyre dhe ligji e garanca në aspektin e normave juridike që parashihen.

Mendoj se aspektet afirmative që u përmendën këtu janë të mira ndoshta, por nuk e ndryshojnë esencialisht çështjen.

U përmend këtu nga përfaqësuesi i USAID-it, për shembull që gjyshja e tij paska qenë pronare apo është bërë trashëgimtare e pronës për të realizuar shtesat minore. Mirëpo, ne jemi duke folur për një gjendje të gjyshes dhe gjyshërve që praktikisht nuk e kanë ndryshuar situatën dhe a do të duhej të shërbente ky shembull, apo po lejohet që gruaja dhe femra shqiptare të jetë vegël për të realizuar një qëllim përfitimi të caktuar?

Mendoj se kjo nuk është qasje e drejtë. Por ne do të duhej të merremi praktikisht sa ne në këtë fazë, nuk do të flasim tash për zgjedhjet a do të mbahen apo s'do të mbahen, apo do të kemi a s'do të kemi sukses ta çojmë deri në fund këtë ndryshim dhe plotësim të ligjit, por vërtet të merremi me masën sa mundemi ne në këtë fazë të ndryshojmë këtë projektligj në mënyrë që të ndryshojmë gjendjen e femrës dhe gruas në shoqëri.

Kjo është çështja konkrete që unë mendoj do të duhej të merreshim ne secili, sepse diskutime të gjata, përmbajtjesore për gjendjen e femrës krejt mund të mbajmë. Krejt kemi gra, nana, motra. Shoqëritë patriarkale nuk mund ta ndryshojmë edhe mentalitetin me këso forma. Vetëm ligji duke i detyruar edhe gjykatat duke i zbatuar... dhe njëkohësisht duke u shtuar. Unë e shoh gjithnjë e më shumë një rol të vetë gruas sot, të femrës, motrës tonë më afirmative në kërkimin e të drejtës së saj.

Domethënë në mes ligjit dhe kërkesës së drejtë të femrës mendoj se duhet ta ndryshojmë gjendjen. Dhe jo me aspekte që praktikisht vetë femra e lejon veten të shndërrohet në një lloj vegle për të realizuar një qëllim prej tyre.

Në daç e bëjmë me 5 poena, në daç me 20 poena, mud të realizohen projektet që ndoshta shërbejnë për të kundërtën e realizimit të një drejte dhe afirmimi të gruas në shoqëri. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit zoti Aliu! Përfaqësuesi nga OSBE!

--

RINOR HOXHA :Faleminderit zonja Kryetare

Përshënetje për të gjithë

Jam RINOR Hoxha, prej OSBE-së!

Vetëm shkurtimisht desha të shtoj se në pikëpamjen e OSBE-së këto 3projektlgje që janë paraqitur në paketë nga Qeveria i avancojnë të drejtat trashëgimore në përgjithësi dhe të drejtat femrave dhe të drejtat e fëmijëve në trashëgimi në veçanti.

Ka masa të sigurisë të cilat parashihen kryesisht në ligjin për plotësim ndryshimin e ligjit për procedurën jashtë kontestimore, të cilat Xhevati disa prej tyre i përmendi. Këto pra i avancojnë të drejtat e femrave në trashëgimi mirëpo po konstatojmë se ka avancim por nuk do të thotë se nuk mund të bëhet më mirë, ndaj çdo amendament apo çdo diskutim që propozohet duhet të diskutohet në mënyrë sa më detalizuar dhe të vlerësohet efekti real në terren. Të gjitha pra janë të mirëseardhura.

Ne kemi bërë komente specifike për Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për trashëgiminë dhe Ministria e Drejtësisë disa prej tyre i ka marrë parasysh. E kemi edhe një koment apo një problem, çështje diskutabile e cila ka mbet, është bashkësia jashtëmartesore edhe në ligjin aktual por edhe në projektligjin e propozuar ende ekziston ai kriteri kumulativ se trashëgimtari mund ta trashëgojë bashkëshortin trashëgimlënës vetëm nëse ka jetuar për një periudhë prej 5 viteve me të në bashkësi jashtëmartesore dhe nëse nga ajo bashkësi jashtëmartesore kanë fëmijë qe 3 vite..

Ne mendojmë se kjo është në njëfarë mënyre diskriminuese sepse edhe ata të cilët kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore dhe nuk kanë fëmijë duhet ta kenë të drejtën e tyre për të trashëguar. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Plotësisht jam dakord me propozimin. Përfaqësuesja nga Polisi, pastaj zonja Salihi e ka kërkuar fjalën , por meqë Sebi është për herë të parë, ia kalojmë fjalën Sebit, pastaj juve.

DONJETA ELSHANI : Faleminderit shumë! Unë jam Donjeta, prej organizatës joqeveritare Polis që vepron në Lipjan. Jam koordinatore e projektit për

angazhimin e të drejtave pronësore të grave, edhe më shumë tash jemi marrë me një lloj analize dhe me rekomandime për Ligjin për noterinë, Ligjin për procedurën jokontestimore dhe Ligjin për trashëgiminë.

Tash meqë veç jemi te Ligji për trashëgiminë ne i kemi dhënë disa propozime tona. Ju disa i përmendët e unë, nëse më lejoni, vetëm do t'i shtjelloja më tutje.

Nën një. Ne kemi si propozim heqjen dorë nga trashëgimia.

Nën 2, heqjen dorë nga trashëgimia te rastet sociale, dhe nën 3, tek bashkëshorti pasjetues.

Te heqja dorë nga trashëgimia. Ne kemi propozuar këtë pasi që e dimë se si është gjendja reale në Kosovë, e dimë se sa femrat trashëgojnë në Kosovë.

Këto gra heqin dorë nga pasuria e tyre, nga ajo se çka i takon veç për faktin se ekziston ende tradita e cila po vazhdon - zakoni, dhe e cila po i dëmton ato financiarisht dhe në çdo aspekt tjetër.

Ne kemi dhënë një arsyetim se pse është e nevojshme kjo dhe pse kjo nuk i dëmton ashtu si po thuhet të drejtat e njeriut, e tjera, e tjera.

Ne kemi konsideruar se në momentin kur gruaja e merr pasurinë, e regjistron pronën në emër të vet, e ka të drejtën për të dhuruar atë pronë.

E dimë se dhurata në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve kjo dhuratë ka, ekziston e drejta e revokimit të dhuratës. E drejta e revokimit të dhuratës nënkupton se në momentin e parë kur po e zëmë gruaja ka fëmijë dhe situata e saj financiare nuk është e mirë, ekziston një e drejtë e tillë që ajo të kthejë dhuratën të cilën ia ka dhuruar, po e zëmë, vëllait.

Është edhe aspekti tjetër, se në momentin kur e regjistron pronën në emër të vet ka shumë njerëz që përtojnë t'i hynë procedurave ose reflekton në mënyrë të arsyeshme dhe thotë jo po e mbaj këtë pronë.

Ne i kemi dhënë anët pozitive dhe anët negative që besoj i keni dhe mund t'i lexoni.

Ne kemi thënë, nën një – ndalohet heqja dorë nga trashëgimia për të gjithë personat të cilët paraqiten si trashëgimtarë.

Ne kemi konsideruar se ky paragraf mund të jetë, nëse nuk kalon tani, mund të kalojë pas një periudhe pesëvjeçare, deri sa të rregullohen pronat e njerëzve se, siç tha zotëriu, ka shumë prona që ende janë të regjistruara në emër të trashëgimlënësve që kanë vdekur para shumë viteve dhe nuk është tjetërsuar ajo pronë.

Ne këtu kemi dhënë një propozim tjetër e ky propozim është në Ligjin për marrëdhënie jokontestimore. Te kjo ne kemi lënë dy afate, të heqjes dorë. Domethënë në momentin që heq dorë e ka një afat që e kemi quajtur rapid” një mujor, që kthehet dhe thotë – valla po e du këtë pasuri se kam menduar, kam reflektuar dhe konsideroj se po më takon kjo pasuri.

Edhe një afat tjetër njëmbëdhjetë mujor. Ky afat njëmbëdhjetë mujor ka të bëjë me regjistrimin, për shembull në emër të vëllait ose në emër të trashëgimtarëve që e kanë pranuar atë pronë por kjo pronë trashëgimtari që ka hequr dorë të ketë të drejtën njëmbëdhjetë mujore, të kthejë dhe të thotë se kam reflektuar dhe konsideroj që këtë pronë duhet ta marrë në emër timin.

Një tjetër që e përenda, është heqja dorë nga trashëgimia lidhur me rastet sociale.

Ne e dimë që shumë gra në Kosovë heqin dorë nga trashëgimia për shkak të traditës sikur që e përmenda, por për veti janë në një gjendje të mjerueshme ekonomike. Çka nënkupton kjo se heqin dorë nga trashëgimia, i dëmtojnë pasardhësit e vet dhe nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për mbijetesë.

Ne kemi thënë që me ia mundësuar noterisë qasjen në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe mos me ua lejuar grave apo personave në përgjithësi që janë në gjendje të vështirë ekonomike të heqin dorë nga e drejta e tyre në pronë.

Pra, ne kemi propozuar që neni 8 i Projektligjit, paragrafi 2 të shtohet edhe një paragraf i ri me këtë përmbajtje: Nuk lejohet heqja dorë nga trashëgimia për trashëgimtarët të cilët janë në asistencë sociale.

Noteri është i obliguar të konstatojë nëse trashëgimtarët janë në asistencë sociale, sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe Oda e Noterëve përmes marrëveshjes me

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenien Sociale obligohet që noterëve t'u krijojë qasje në regjistrin e personave të cilët marrin pjesë në asistencë sociale.

Kjo pra bëhet me qëllim të vetëm në mënyrë që gratë.... është edhe aspekti tjetër financiar për shtetin pasi që shteti lirohet për t'i mbajtur dhe marrin pronën që u takon në emër të tyre.

Një situatë tjetër për të cilën të gjithë jemi të informuar është tek bashkëshorti pasjetues. Kemi rastin e Shyretes – Shyrete Berisha e cila nuk mund të trashëgojë për shkak se ligji për trashëgiminë ka mangësi.

Kjo është plotësisht e padrejtë. Kemi edhe shumë raste të tjera të cilat nuk janë mediatike dhe që këto raste nuk i dimë, por ekzistojnë.

Ne kemi propozuar tek neni 12 i Ligjit pas paragrafit 2 të shtohet një paragraf i ri 3, si vijon:

“Të drejtën në trashëgimi do ta ketë edhe bashkëshorti pasjetues, edhe nëse gjatë jetës me bashkëshortin tashmë të ndërë nuk kanë pasardhës.

Ai/ajo do të trashëgojë në emër të bashkëshortit të vdekur sikur bashkëshorti i ndërë të ishte i gjallë e që do të kishte të drejtën të trashëgojë sipas këtij ligji.

Ne këto propozime i kemi bërë duke shikuar situatën në terren. Polis ka bërë monitorimin e Gjykatës në Lipjan për çështje të trashëgimisë dhe sipas këtyre të dhënave dhe analizës që ia kemi bërë këtyre projektligjeve, kemi ardhur në këto konstatime. Faleminderit!

KRYETARJA: : Faleminderit po ashtu!

Tash si duket Grupi punues ka me pas goxha punë për t'i shqyrtuar këto propozime. Pjesa dërmuese e tyre natyrisht besoj se s'do të ketë problem të marrin mbështetjen dhe uroj që të kemi një punë ndoshta edhe intensive në mënyrë që ky Projektligj me ndryshimet e propozuara të kalojë sa më parë. Fjalën e ka zonja Sebahate Grajçevci!

SEBAHATE GRAJÇEVCI: Mua po më vjen mirë që jeni në këtë temë me bazë duke e prekur dhe po besoj që në të ardhmen do të kemi një ligj shumë më të mirë. E përmendi edhe zonja Kada dhe të tjerët që të drejtën në trashëgimi shumë pak gra e shfrytëzojnë. Është përmendur 5% dhe faktikisht është ende më i vogël kur kemi parasysh se këtë pronë e trashëgojnë në shumë shumë më të vogël, edhe

dikush merr nuk e merr atë nga ndarja proporcionale por ndoshta një pjesë simbolike dhe në anën tjetër trashëguesit në femra janë në shumicën e rasteve vajzat të cilat nuk kanë vëllezër e jo edhe që ndahet pasuria në mënyrë proporcionale me vëllezërit.

Patjetër se duhet marrë masa afirmative mirëpo ligji është ai i cili u garanton më tepër dhe siguron që kjo e drejtë të realizohet.

Shumëkush e preku çështjen e heqjes dorë nga trashëgimia. Ne edhe më parë e kemi rrahur këtë çështje kemi konsideruar që heqja dorë të bëhet pasi të bëhet regjistrimi i asaj pasurie, pasi që ta posedojë, dhe nëse edhe vendos ta falë dikush le të thotë faleminderit që ma fale, por jo të heqë dorë ende pa e poseduar.

Prandaj, te neni, po më duket është 130, në pikën e fundit konsideroj që duhet të shtohet një amendament të cilin do ta dërgoj edhe me shkrim që trashëgimtari mund të heqë dorë nga e drejta trashëgimore vetëm pasi ta ketë regjistruar si të veten dhe ta posedojë atë për një periudhë prej 5 vitesh. Ndoshta edhe vitet mund të jenë më pak por së paku një herë ta regjistrojë si të veten.

Unë e konsideroj si problematike edhe çështjen e cedimit të pasurisë trashëgimore. Në raste shumë jo të vogla, shumë herë u përmend edhe nga zoti Azemi dhe disa të tjerë se shpeshherë vetëm një nga anëtar të familjes ose një nga trashëgimtarët i kryen të gjitha procedurat dhe anëtarët tjerë ose trashëgimtarët tjerë as që dinë çka po ndodhë ose marrin një nënshkrim, e falsifikon dikush edhe dokumentacionin e tij dhe duhet të lihet mundësia ndoshta te procedurat jokontestimore që në çdo rast në se paraqitet një trashëgimtar i cili nuk është i kënaqur me cedimin e pasurisë që procesi të kthehet në nult, të rifillohet.. Kaq kisha unë. Më vjen mirë që shumëçka që kisha në mendje u tha kështu që s'dua t'i përsëris tjerët. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit po ashtu zonja Grajçevci! Për ata të cilët nuk e kanë të njohur, zonja Grajçevci e ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe me gratë deputete në legjislatura të ndryshme, ka qenë po ashtu deputete dhe natyrisht se i di problemet me të cilat ballafaqohen vajzat e gratë, sidomos edhe në këtë çështje të cilën po e diskutojmë. Tani fjalën e ka zonja Salihu!

VALBONA SALIHU... Shumë pak, ndoshta disa sqarime. Unë isha kthyer te ajo që çka pengon nëse jetë në kompetencë të gjykatës edhe noteri. Nuk e kisha mendjen që noteri të përjashtohet por të jenë të dyja për shkaqe pikërisht e para ekonomike dhe arsye tjera. Ka njerëz që kanë përvojë të ndryshme në punën

noterisë që shtrenjtë apo lirë por ne tani po kufizohemi në çështjen trashëgimore që vërtet ajo gjendje që e thash, më herët e kemi parë në hulumtimin e punës së tyre.

Këtë shifër që e tha zotëriu nga USAID-i,¹⁵ apo më shumë që posedojnë gratë, ajo është, që e preku edhe zonja Sebahate, prona që vetë e fitojnë vajzat apo gratë në forma të ndryshme pronën, është në trashëgimi kur janë vetëm vajzat apo nana dhe në pronën e përbashkët të bashkëshortëve, do të thotë ajo pjesa, kurse trashëgimi ende fatkeqësisht ekziston varësisht prej hulumtuesve 5 apo edhe më poshtë.

Për heqje dorë nga trashëgimia, edhe një herë po kthehem se të gjitha ato që u cekën edhe nga folësit është mënyrë vullnetare, do të plotësonin apo do të përparonin deri diku gjendjen e keqe çfarë tani është por sidomos të themi Ballkani pa u detyruar është vështirë me vullnet të arrijë. Këtë po e them shumë në mënyrë të përgjithësuar por unë them se edhe në komunikacion mund të jetë, për shembull.... ose vullnetarisht në qoftë se ka shpejtësinë shumë më të madhe ta paguajë por fatmirësisht që janë gjobat dhe format e ndryshme të detyrimit që ata ta bëjnë. Kështu jemi të tillë, kemi ende mentalitetin patriarkal shumë të fortë prandaj duhet masa afirmative, duhen vaksinat, thjeshtë me thënë që ajo sëmundje pak të zbutet se sigurisht që nuk mund të shërohet për një vit, dy po dhjetë a më shumë, por në mënyrë vullnetare, me vetëdijesim e veçanërisht ajo që është propozuar se të njoftohet pala se ka të drejtë me aq të kryhet, unë mendoj se edhe 50 vjet minimum nuk mund të arrijmë asnjë minimum e mos të them se atë gjithqysh as në shtetet më të zhvilluar s'e kemi 100% barazi gjinore. Faleminderit.

KRYETARJA: Faleminderit po ashtu! Dikush tjetër? Si po duket, nuk paraqitet askush për të marrë fjalën.

Atëherë, në emër të Komisionit për Legjislacion ju falënderoj jashtëzakonisht shumë për kontributin që e keni dhënë.

Unë ju sugjeroj që deri më 18 prill, apo të shoh kur është 18 prilli. Pra, e hëna i bie pushim dhe me 19 prill, për shkak se për konfliktin e interesit jemi dakorduar që deri të mërkurën e ardhshme t'i dërgoni vërejtjet, komentet me shkrim për këtë projektligj dhe pastaj pas dërgimit të vërejtjeve e komenteve, të rekomandimeve apo sugjerimeve grupi punues do të mbledhet. Po ashtu do të jeni të ftuar që të merrni pjesë në punën e grupit punues në mënyrë që bashkërisht t'i diskutojmë edhe një herë dhe përpilojmë amendamentet për seancën plenare.

Pra, edhe një herë ju falënderoj dhe shihemi në takimet tjera.